



Dhjetor 2022

Pasqyra e Eventeve



Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike – 10 Vjetori i një Bashkëpunimi të Suksesshëm!



Më 8, 9, 10 Nëntor 2022, SHUKALB në bashkëpunim me SHUKOS (Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimit të Kosovës) organizuan Konferencën dhe Ekspozitën e 10-të të Përbashkët Ballkanike me temë **“Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme”**, në Hotel Emerald, në Prishtinë, Kosovë. Konferenca tërhoqi mbi 400 profesionistë të ujit që përfaqësonin shoqëritë ujësjellës kanalizime, komunitetin e donatorëve, kompani private, institucione akademike si dhe institucione të tjera të qeverisjes qendrore dhe vendore nga 16 vende të ndryshme.

Si zakonisht, Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike ofroi një platformë për diskutim, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të ndanin njohuritë dhe përvojën e tyre në

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Seminari i 8-të i IWA për Modelimin e Rigjenerimit të Burimeve Ujore](#)

Stellenbosch, Afrika e Jugut
18-22 Janar 2023

[Webinar mbi Rishikimin e Direktivës së Trajtimet të Ujërave të Ndotura Urbane](#)

Online
27 Janar 2023

[Konferenca e 17-të e Forumit Danez për Kërkimin e Ujit](#)

Bjerringbro, Danimarkë
8 February 2023

trajtimin e çështjeve të sektorit të ujit dhe krijimin e mundësive të rrjetëzimit midis profesionistëve të sektorit të ujit në Rajonin e Ballkanit.

Para fillimit të Ceremonisë së Hapjes, më 8 Nëntor, u organizuan disa evente para-konferencë duke përfshirë **Forumin e Grupimit të Profesionistëve të Rinj të Ujit** nga Kosova dhe Shqipëria; **Workshopi Rajonal i Programit të Benchmarking për HUB-in Kosovë dhe Shqipëri**, **Takimi i Përbashkët me Palët e Interesit mbi “Zhvillimin e Kapaciteteve në Sektorin e Ujit dhe Advokimin e Shoqatave për Krijimin e një Mjedisi Mbështetës”**, dhe **Workshopi i Grupit DHI me temë “Analiza Hidraulike e Sistemit të Furnizimit me Ujë ose Binjakëve Dixhitalë për Menaxhimin e Ujit Pa të Ardhura dhe të Energjisë së Shoqërive Ujës-jellës Kanalizime”**. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB vjen me një dizajn të ri të faqeve të internetit!



SHUKALB ka përmirësuar së fundmi dy faqet e tij të internetit www.shukalb.al dhe <https://balkansjointconference.org>, si një përpjekje për të forcuar kapacitetet organizative dhe për të lehtësuar shërbimet më efektive ndaj bashkëpunëtorëve dhe menaxhimin e marrëdhënieve. Të dy faqet e internetit përmbajnë veçori të reja, janë të thjeshta për t'u naviguar dhe ofrojnë informacion në një mënyrë lehtësisht të arritshme. Përveç kësaj, faqja e re e internetit SHUKALB ka një ndërfaqe më të mirë me SHUKALB CRM dhe integrim me faqet e internetit të organizatave partnere dhe mediat sociale.

Ju ftojme që tani të klikoni në lidhjet e mëposhtme për të vizituar faqet tona të reja të internetit:

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujës-jellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

<https://shukalb.al/sq/>

<https://balkansjointconference.org/sq/>

SHUKALB organizon Trajnimin Gjenerik për Trajnerët me temë “Të nxënit të të rriturit dhe aftësitë e buta në ofrimin e trajnimeve”



Në datën 16 nëntor 2022, në Tiranë, SHUKALB organizoi Trajnimin për Trajnerët (ToT) me temë “Të nxënit të të rriturit dhe aftësitë e buta në ofrimin e trajnimeve” në kuadër të projektit Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve (RCDN) për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve.

Në ToT morën pjesë trajnerë të SHUKALB dhe RCDN-së, të cilët përfaqësonin Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime Tiranë, Shkodër, si dhe SHUKALB. ToT u drejtua nga Arian Gjorga, Ekspert i pavarur.

Objektivi kryesor i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të merrnin njohuri teorike dhe praktike se si të planifikonin, organizonin dhe ofronin trajnime. [lexo më shumë](#)

Lajme nga anëtarët tanë

Qeveria Shqiptare dhe Agjencia Franceze për Zhvillim nënshkruajnë marrëveshjen për financimin e rrjetit të ujësjetëlës të Durrësit



Gjatë muajit nëntor 2022, në ambientet e Kryeministrit të Shqipërisë, Qeveria e Shqipërisë dhe Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD) nënshkruan një marrëveshje e cila do të akordojë fonde me vlerë prej 61 milionë euro për investime në Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Durrës në rrjetin e saj të furnizimit me ujë. Marrëveshja u nënshkrua nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj dhe Sekretarja Franceze e Shtetit për Evropën, Laurence Bonne, në prani të kryeministrit Edi Rama dhe ambasadores së Francës në Tiranë, Elisabeth Barsacq.

Nga shuma totale e fondit, 60 milionë euro janë kredi, ndërsa 1 milionë janë grante. Investimi përfshin 3 komponentë: [lexo më shumë](#)

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër reagon me shpejtësi në përgjigje të situatës së përmbytjeve



Gjatë muajit nëntor Bashkia e Shkodrës u përball me një situatë të rëndë përmbytjesh. Reshjet me intensitet të lartë, shoqëruar me shkarkimet nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin, kanë sjellë përmbytje në territorin e qytetit të Shkodrës, si dhe në disa njësi administrative të Bashkisë Shkodër.

Në përgjigje të kësaj situatë, shoqëria UK Shkodër në koordinim me strukturat e tjera të Bashkisë Shkodër reagon me shpejtësi duke marrë masat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të ujësjiellës kanalizimeve.

Grupet e terrenit dhe mjetet e UK Shkodër, ishin në gatishmëri të plotë për të garantuar qarkullimin e qytetarëve dhe mjeteve, duke mbajtur në monitorim dhe duke ndërhyrë aty ku ishte e nevojshme, me zhblokimin e kanalizimeve të ujrave të bardha. Në jo pak raste, kanalizimet bllokoheshin nga gjethet e pemëve dhe pastrimi i tyre, ishte domosdoshmëri. [lexo më shumë](#)

Të tjera

Aplikoni tani për Programin e D-LeaP Menaxhimi i Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime!



Tashmë janë hapur aplikimet për ciklin e dytë të Programit të **D-LeaP Menaxhimi i Shoqërive UK (Utility Management Training-UMT)**, i cili do të nisë në fillim të vitit 2023.

Programi nisi në vitin 2021 si një klasë master dyvjeçare modulare moderne për menaxhimin holistik në sektorin e shërbimeve të ujit, dhe përfundoi sipas planit, pavarësisht nga të gjitha emergjencat e lidhura me pandeminë, UMT është një program që përforcon aftësitë e profesionistëve në shoqëritë ujësjiellës kanalizime, dhe gjithashtu një thesar njohurish për vendimmarrësit në industri dhe administratat me interes në sektor.

Në vazhdim, dëshirojmë të theksojmë se Banka Botërore me mbështetjen e Bursave të Global Water Security and Sanitation Partnership (GWSP) fton stafin e kualifikuar të shoqërive UK, të cilët synojnë të marrin pjesë në UMT dhe që kanë nevojë për ndihmë financiare për t'u bashkuar me programin, të aplikojnë për një **bursë bashkëfinancimi që mbështet pjesëmarrjen!** Bursa mund të mbulojë deri në **70% të tarifave të pjesëmarrjes**.

Për më shumë informacion mbi programin, [formen e aplikimit](#), modulet, tarifat e pjesëmarrjes dhe [mundësinë për bursë](#) ju ftojmë të ndiqni linkun mëposhtë:

<https://www.iawd.at/eng/danube-toolbox/d-leap/programs/utility-management-training/>

Webinar mbi Trajtimin e Ujërave të Ndotura dhe Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë – Të mësojmë nga përvoja e Evropës Qendrore dhe Lindore

Webinari organizohet nga Global Water Partnership Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Universiteti i Lubjanës nën kujdesin e Komunitetit të Praktikave mbi Zgjidhjet e bazuara në Natyrë në Menaxhimin e Ujit. Webinari do të zhvillohet më **14 dhjetor në orën 13:00 – 14:30 CET**.

Webinari është i hapur për një audiencë globale të praktikuesve, akademikëve, vendimmarrësve, pasi temat që diskutohen janë të rëndësishme për shumë rajone të botës që përballen me sfida të ngjashme. Më tej, pjesëmarrësit do të ftohen të vazhdojnë angazhimin dhe shkëmbimin në hapësirën online të Komunitetit në platformën GWP.

Linku në Zoom: <https://us06web.zoom.us/j/82179290751?pwd=V2kwOHQ3S0txOWkraEtMdVQ4YVJWdz09>

Regjistrimi: <https://forms.gle/VgFF4Kb1K6fbjS557>

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kursët e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu

Unsubscribe